

**VENDIM**  
**Nr.11, datë 8.2.2010**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HIDROALBANIA ENERGJI” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5 pika 1 germa “a”, nenit 13 dhe nenit 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.2.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HIDROALBANIA ENERGJI” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).

Për dokumentacionin që ka të bëjë me: miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centraleve me sistemin elektroenergjetik, aplikuesi është në pritje të miratimit të saj për ta paraqitur më pas në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë “HIDROALBANIA ENERGJI” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me kusht që të paraqesë dokumentin e miratimit të pikës së lidhjes me sistemin elektroenergjetik para fillimit të operimit të HEC-ve.

2. HIDROALBANIA ENERGJI” sh.p.k. të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Borje, Oreshkë, Cernalevë, Cernaleve 1, sipas afatit të përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.

3. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**